



Republika e Kosovës – Република Косово – Republic of Kosovo

Qeveria – Влада – Government

Zyra e Kryeministrit – Канцеларија премијера – Office of The Prime Minister

Zyra e Komisionerit për Gjuhët – Канцеларија повереника за језике

Office of the Language Commissioner

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt propozimeve të OJQ-ve

10.06.2019

Bazuar në Thirrjen Publike me nr protokoli 1751 të datës **10.06.2019** të lëshuar nga Zyra e Komisionerit për gjuhët për thirrjen publike **për mbështetje financiare për projekte/programe të OJQ-ve, me qëllim të promovimit dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore**, ftojme organizatat jo qeveritare/shoqërinë civile, të aplikojnë për të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit, në cilësinë e ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve.

Rregullorja MF- Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësueses për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë përfaqësues të OJQ-ve. Për këtë qëllim, **Zyra e Komisionerit për gjuhët** fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e komisionit vlerësues si ekspertë të jashtëm, për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;

- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: zkgj.kpj@gmail.com dhe arta.pllana@rks-gov.net jo më larg se 20.06.2019. Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ndërtesën e Qeverisë, Sheshi Nëna Terezë, Zyra Nr. 605 A, Kati 6.